

gjendjes së rëndë shëndetësore të Fanës. Ishte kjo hera e fundit që ata të shiheshin të gjallë. Në datën **26.07.1998**, banorët e fshatit, të cilët ishin të fshehur në pyllin e afërt, kanë parë kur pjesëtarët e forcave serbe kanë hyrë në oborin e Aliut dhe Fanës, si dhe shtëllungat e tymit që u paraqitën nga shtëpia pas 15 minutash. Tre muaj më vonë [27.10.1998], vëllai i Aliut, Shabani, u kthye në fshat dhe në shtëpinë e djegur i ka gjetur mbetjet mortore të Aliut dhe Fanës. Po atë ditë, me ndihmën e bashkëshortes dhe djalit, i ka varrosur Aliun dhe Fanën në varrezat e fshatit, ku prehen edhe sot.

**Burimet:** deklarata H.M, FDH-36616; *Albanian Couple Killed by Serb Forces Several Months Ago, Buried over Weekend*, pasqyra e lajmeve, KIC, 02.12.1998, FDH-30758.

### **Salih (Azem) Kajtazi**

(5.05.1933, shqiptar nga Klina e Mesme/Srednja Klina, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, pesë fëmijë)

Salihu punonte në Fabrikën e Tjegullave *Ardhmëria/Budučnost* në Skënderajt/Srbica. Me familje jetonin në Klinën e Mesme/Srednja Klina. Kur forcat serbe u pozicionuan në afërsi të fshatit më 20.07.1998, ai me të rejtën dhe nipërit u zhvendos te miqtë në Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze. Dy ditë më vonë [26.07.1998], Salihu shkoi në **Klinën e Mesme/Srednja Klina** për ta ushqyer bagëtinë. Në kthim, pjesëtarët e forcave serbe e kanë vërejtur Salihun te lumi *Srbica* dhe kanë shtënë ndaj tij. E kanë plagosur në stomak dhe në këmbët. Salihu arriti që të kthehej në shtëpi dhe të strehohej në bodrum. Në orët e mbrëmjes, atje e kanë gjetur djemtë Jahiri dhe Bahtiri. Të nesërmen, e bartën me qerre në spitalin e UÇK-së në Likoc/Likovac. Ka ndërruar jetë pas tri orësh. Familjarët e kanë varrosur në të njëjtën mbrëmje në Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze. Pas dy muajsh, më 2.09.1998, i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në Varrezat e Reja në Klinën e Poshtme/Donja Klina.

**Burimet:** deklarata T.K, FDH-17324; *Serb Forces Embark on Large-Scale Attack in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 27.07.1998, FDH-29378.

### **Habib (Avdullah) Suhogërrla**

(18.12.1953, shqiptar nga Çubrel/Çubrelj, komuna e Skënderajt/Srbica, shitës, tre fëmijë)

Habibi me bashkëshorten Xhejlanan, e cila ishte shtatzëne, dhe fëmijët jetonin në bashkësi familjare me prindërit e tij, Avdullahun dhe Shemsijen. E mbante familjen me shitjen e pemëve në pazar. Për shkak të sulmit të forcave serbe mbi mëhallën e tyre më **28.07.1998**, Habibi e ka strehuar familjen te motra Hyrije në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica, ndërkaq ai me të atin u fshehën në një pyll përkaj fshatit. Po atë ditë, por pak më vonë, Avdullahu shkoi në fshat për ta ushqyer bagëtinë. I brengosur për të atin, Habibi u nis pas tij. Përderisa Avdullahu gjendej në ahur, Habibi e priste jashtë [Çubrel/Çubrelj]. Papritmas, Avdullahu i dëgjoji disa të shtëna. Pas pak, dy ushtarë erdhën dhe e morën me vete Avdullahun. Para largimit nga oborri, e bastisën shtëpinë dhe i morën disa gjësende. Avdullahun e moshuar e çuan në *Mëhallën Buliqi*. Nuk kishte kurrfarë gjurmësh të Habibit. Avdullahu shkante për çdo ditë të shtëpia dhe e priste të birin, por ai nuk paraqitej. Fati i Habitit nuk ishte i njohur deri më 6.02.1999, kur dy kushërinjtë e familjes Suhogërrla e gjetën trupin e tij në periferi të fshatit, te vendi i quajtur *Përroi i Qubrelit/Çubreljski* potok. E njohën në bazë të letërnjoftimit. Habibin e kanë varrosur më 10.02.1999 në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata Xh.N, FDH-15406; deklarata E.D, FDH-18986.

### **Kadri (Kadri) Pajaziti**

(1920, shqiptar nga Çubrel/Çubrelj, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tetë fëmijë)

Forcat serbe u stacionuan në muajin korrik të vitit 1998 në fshatin Runik/Rudnik. Familja e Kadriut e braktisi Çubrelin/Çubrelj dhe u strehua te farefisi në Tushilë/Tušilje. Në shtëpi ndenjën vetëm Kadriu me djalin Eminin. Gjatë ditës qëndronin në pyll, përderisa natën e kalonin në shtëpi. Ditën e martë, më **28.07.1998**, forcat serbe kanë hyrë në **Çubrel/Çubrelj** nga drejtimi i Runikut/Rudnik. Emiri me kushërinj e braktisën fshatin, ndërkaq Kadriu ndenji në shtëpi. Ishte kjo he-